**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT**

Tiranë më 31.05.2024

# REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

## MAJ 2024

**Për dijeni: znj.Arta Dollani**
**Drejtor I Përgjithshëm**

**Nga: Erilda Hoxha**
**Koordinatore e të Drejtës për Informimim**

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | 02.05.2024 | Në bazë të ligjit Nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" AKM të na vendosë në dispozicion | 02.05.2024 | Lidhur me kërkesën për informacion mbi procedurën e ndjekur në hartimin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për heqjen e 600 hektarëve nga zona e mbrojtur Lumi Vjosa, ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:<br><br>Ju bëjmë me dije se AKM shqyrton aplikime në mbështetje të *Ligjit Nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin Nr. 10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis"*, dhe *VKM 714, datë: 06.11.2019, për disa ndryshime* | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | kopjen e raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Parkun Kombëtar "Lumi Vjosë", subjektin që e ka hartuar dhe të gjitha materialet mbi këtë procedurë. | | *dhe shtesa në VKM 686, datë: 29.07.2015, "Për miratimin e rregullave, përgjegjesive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore", të ndryshuar*, AKM shqyrton vetëm aplikime të aplikuara në *E_Albania* sipas shtojcave I dhe II të Ligjit.<br><br>**AKM nuk ka marrë në shqyrtim asnjë kërkesë dhe nuk ka dhënë Vendim VNM për Parkun Kombëtar "Lumi Vjosë".** | | |
| 2. | 11.04.2024 ( kërkeue-sja nuk është azhorunu-ar me njoftimin e faqes së AKM-së. gjatë kësaj periudhe kërkesa të drejtoheh në info@akm.gov.al ose në adresën | Me anë të kësaj kërkese, dëshiroj të di nëse ka aplikim të ri të KESH për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis sa i përket projektit të hidrocentral-it të Skavicës.<br><br>Nëse po, mundet të kem të dhënat e aplikimit? | 02.05.2024 | Agjencia Kombëtare e Mjedisit mori në shqyrtim aplikimin e subjektit "Koorporata Elektroenergjetike Shqiptare" sh.a, në lidhje me procedurën për njoftim të procedurës së thelluar të VNM-së për projektin "Hidrocentrali i Skavicës", me vendodhje në luginën e Drinit të Zi. Subjektit është refuzuar automatikisht nga sistemi i *e_lejeve*, pas tejkalimit të afatit ligjor.<br><br>Subjekti **Koorporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a** nuk ka riaplikuar për kryerjen e procedurës së VNM-së së Thelluar. | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | oltjana.tlha@akm.gov.al) | | | | | |
| 3. | 02.05.2024 | Lutemi të më ndihmoni me një informacion në lidhje me lejet ose licencat e nevojshme, me të cilat duhet të pajiset një subjekt i cili do hapet rishtazi, me objekt veprimtarie bar, restorant. | 02.05.2024 | Referuar kërkesës suaj në lidhje me subjektin i cili do të rihapet rishtaz me objekt veprimtarie Bar - Restaurant, ju bëjmë me dije se:<br><br>Veprimtaritë që janë objekt i ligjit Nr.10448 datë 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit" i ndryshuar janë të klasifikuara në shtojca 1 e këtij ligji.<br><br>Referuar veprimtarisë që ju deklaroni "Bar - Restaurant" ju informojmë se kjo veprimtari nuk është pjesë e shtojca 1 e ligjit Nr.10448 datë 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit" i ndryshuar.<br><br>Nëse ju do të zhvilloni veprimtari të cilat janë të përfshira në shtojca 1 e ligjit Nr.10448 datë 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit" i ndryshuar ju duhet të filloni procedurën për t'u pajisur me leje mjedisi! | Përfunduar | Nuk ka |
| 4. | 03.05.2024 | 1. Vlerat e të gjitha parametrave të matura në Basenin Ishëm-Erzen në vitet 2019,2020, 2022,2022 dhe nëse është e mundur dhe | 13.05.2024 | 1-Lidhur me pyetjen 1, përgjigjen e gjeni duke aksesuar në faqen zyrtare të AKM-së https://akm.gov.al/raporte-dhe-publikime/ , kapitulli Ujërat - monitorimi i cilësisë së ujërave sipërfaqësore.<br>2- Raporti i Gjendjes në Mjedis për vitin 2023 është në fazën e përgatitjes. Parashikohet të publikohet në faqen zyrtare të AKM gjatë muajit Qershor.<br><br>3-Lutemi për këtë informacion drejtohuni Qëndrës Kombëtare të Biznesit. Referuar Ligjit Nr.10081/2009 "Për lejet dhe licensat", VKM Nr.419/2014, e ndryshuar, operatorët aplikojnë pranë QKB, nga ku dhe pajisen me leje mjedisore nga QKB. | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | për vitet 2023.<br><br>2. Kur mund të publikohet Raporti mjedisor i vitit 2023?<br><br>3. Cilat janë subjektet të cilat operojnë në inceneri-min dhe/ ose përpunimin e mbetjeve farmaceuti-ke në Qarkun e Tiranës? | | | | |
| 5. | 05.08.2024 | Lutem eshte e mundur te me konfirmoni nese enti juaj leshon dokumentin e cituar sa me poshte:<br><br>Relacion Teknik - Impianti i | 05.08.2024 | Në vijim të informacionit të kërkuar, Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk lëshon dokumentin "Relacion Teknik - Impianti i Tokëzimit të një fabrike". | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Tokezimit te nje fabrike. | | | | |
| 6. | 07.05.2024 | Interesohem për dokumentacionin e nevojshëm (leje, autorizime, licensa) për hapjen e një fabrike për manufakturim/prodhim të pjesëve mekanike për industrinë e aviacionit. | 09.05.2024 | Në vijim të informacionit të kërkuar mbi dokumentacionin e nevojshëm vijon si më poshtë:<br><br>Veprimtaritë që janë objekt i ligjit Nr.10448 datë 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit" i ndryshuar janë të klasifikuara në shtojca 1 e këtij ligji. Dokumentacioni për veprimtaritë është i përcaktuar në Kreu II dhe III të VKM Nr.419 datë 25.06.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A dhe B për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja"<br>Kërkuesi që aplikon pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) për pajisjen me leje mjedisi të tipit A, duhet të dorëzojë këto dokumente:<br>a) Formularin informues për pajisje me leje mjedisi të tipit A, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi;<br>b) Mandatpagesën për tarifën përkatëse për lejen e mjedisit të tipit A, sipas nenit 25 të ligjit nr.10448, datë 14.7. 2011, “Për lejet e mjedisit”;<br>c) Çdo informacion tjetër që kërkuesi i lejes kërkon të merret parasysh gjatë shqyrtimit të aplikimit;<br>ç)Raportin mbi sigurinë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e rreziqeve nga aksidentet madhore, kur kërkohet;<br>d) Relacion rreth dëgjesës me publikun, sipas përcaktimit në pikën 13 të kreut V të këtij vendimi<br>Kërkuesi që aplikon pranë QKB -së për pajisjen me leje mjedisi të tipit B duhet të dorëzojë këto dokumente:<br>a) Formularin informues për pajisje me leje mjedisi të tipit B, sipas shtojcës 2, bashkëlidhur këtij vendimi;<br>b) Mandatpagesën për tarifën përkatëse për lejen e mjedisit të tipit B, sipas nenit 25 të ligjit nr.10448, date 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”; | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | c) Çdo informacion tjetër që kërkuesi i lejes kërkon të merret parasysh gjatë shqyrtimit të aplikimit;<br>ç) Raportin mbi sigurinë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e rreziqeve nga aksidentet madhore, kur kërkohet.<br>dh) Relacionin rreth dëgjesës me publikun, sipas përcaktimit në pikën 13 të kreut V të këtij vendimi.<br><br>Në bazë të Shtojcave I dhe II, të Ligjit nr. 10 440, datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", të ndryshuar, projekti i deklaruar nga subjekti "Për hapjen e nje fabrike për manufakturim/prodhim të pjesëve mekanike për industrinë e aviacionit",duhet t'i nënshtrohet Procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.<br><br>Procedura e aplikimit kryhet nëpërmjet platformës qeveritare "e-albania", në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit Nr.153 Prot, datë: 25.11.2019 "Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm on-line nga data: 01.01.2020". | | |
| 7. | 03.05.2024 | Isha i interesuar për matjen e nivelit të zhurmës brenda banesës dhe mënyra si procedohet në këto raste, kam një lokal poshtë shtëpisë dhe kam problem me volumin e | 07.05.2024 | Referuar kërkesës tuaj, AKM trajton vetëm subjektet që janë të pajisura me Leje Mjedisi.<br>Sa i përket rastit konkret lutem ti trejtoheni Policisë Bashkiake. | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | lartë të muzikës.<br><br>. | | | | |
| 8. | 08.05.2024 | Ne jemi një grup studentësh të degës inxhinieri agromjedisi në Universitet-in Bujqësor të Tiranës. Jemi në përfundim të ciklit të studimit bachelor dhe na nevojitet që për ta përmbyllur këtë cikël studimesh ta kryejmë praktikën në një institucion mjedisor. Doja të dija nëse e ofron institucioni juaj këtë mundësi | 09.05.2024 | Agjencia Kombëtare e Mjedisit pranon praktika mësimore nga studentët në fakultete të ndryshme.<br>Ju bëjmë me dije se në kërkësen për praktikë e cila vjen zyrtarisht nga Universtiteti të cilësohet kohëzgjatja e praktikës. | Përfunduar | Nuk ka |
| 9. | 08.05.2024 | Aktualisht po | 09.05.2024 | Në vijm të informacioni të kërkuar nga ana juaj, bëjmë me dije se : | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | përfundoj studimet në master profesional "Inxhinieri Gjeomjedisi " pranë Fakultetit Gjeologjisë dhe i Minierave . Për formalitet diplomohem në korrik.Isha interesuar nëse prej jush ofrohet intership me qëllim punësim pranë AKM mbas diplomimit . Nëse ka ndonjë mundësi afrimi pranë institucionit tuaj , nëpërmjet Intership , intern ,kohë e pjesshme ose e plotë , me mentor , | | -Agjencia Kombëtare e Mjedisit pranon kërkesa për praktika mësimore të cilat vijnë zyrtarisht nga Fakultetet dhe me afat të përcaktuar. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | do isha shumë interesuar . | | | | |
| 10. | 13.05.2024 | Jemi një shoqëri që kemi për objekt të veprimtarisë prodhim, përpunim, operacione fason dhe tregëtim të komponentë-ve për ajrin e kondicionu-ar në automjete, import eksporti i tyre.<br>Nga kryerja e veprimtarisë, gjatë përpunimit të aluminit, prodhohen mbetje të aluminit, të cilat janë klasifikuar si mbetje jo të rrezikshme | 21.05.2024 | Në përgjigje të kërkesës tuaj ju bëjmë me dije se referuar “VKM-së Nr.538 datë 26.5.2009 Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” cdo operator që kërkon të pajiset me licencë të nënkategorisë III.2.B duhet që të sigurojë trajtimin/asgjësimin e mbetjeve, kjo mund të bëhet nëpermjet vet operatorit i cili mund të jetë edhe mbajtës i lejes së mjedisit kategoria III.1 ose nëpërmjet operatoreve të tjerë të cilët plotësojnë kushtet sipërcituar. Për dokumentacionin e duhur për pajisjen me licencë III.2.B referojuni VKM-së sipërcituar në të cilën janë të përcaktuara kushtet qe duhet të plotësoje operatori. | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | me Kodin Doganor 7602 0019 (mbetje të tjera alumini). Duke qenë se veprimtaria jonë kryhet si nënkontrakt-or për shoqerinë meme e cila ndodhet në Itali, këto mbetje alumini duhet të eksportohen në shtetin e Italisë. Ndaj jemi në fazën që po përgatisim dokumentac-ioni për tu pajisur me autorizimin përkatës për eksportin e tyre, sipas VKM Nr. 641 datë 01.10.2014 "Për miratimin e | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshmee e të mbetjeve inerte", i ndryshuar. Ndër dokumentat që kërkohet është edhe Licencsë për nënkategori në III.2.B që specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme. Shoqëria nuk kryen veprimtari lidhur me | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | menaxhimin e mbetjeve pasi menjëherë pas krijimit, këto mbetje merren nga një kompani e tretë e licensuar për menaxhimin e mbetjeve, me të cilën kemi kontratë shërbimi, me mjetet e tyre të transportit dhe ruhen në magazinat e tyre, në pritje të procedurave për eksportim në shtetin e Italisë. Eksporti parashikohet të bëhet nga shoqëri transporti të licensuara për këtë veprimatri | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | me të cilët do të lidhet kontratë sipas parashikime-ve ligjore. Shoqëria nuk e kryen transportin e tyre dhe nuk ka mjete të dedikuara, pasi nuk e ka në objekt të veprimtarisë së saj menaxhimin e mbetjeve dhe nga një vlerësim kosto-përfitim, nuk mund të blejë mjete transporti vetëm për transportin e këtyre mbetjeve jo të rrezikshme pasi kostot janë shumë të larta.<br><br>Sa më sipër kërkojmë | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | informacion-in si më poshtë:<br><br>Ndodhur në këtë situatë çarë document-ash duhet të praqesë Soqëria në aplikimin për tu pajisur me licensë II.2.B?<br><br>A është e mundur që në aplikimin me Licensë III.2.B të praqitet si dokumenta-cion kontrata e shërbimit që shoqëria ka me shoqëri të tjera për transnportin e mbetjeve jo të rrezikshme (të cilat e kanë Licensën | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | III.2.B) ose kontratë qiraje për mjetet që do të përdoren për transportin?<br><br>Cfarë profili, cilën diplomë duhet të ketë Drejtuesi Teknik në rastin konkret? | | | | |
| 11. | 13.05.2024 | Jam studente e Drejtësisë në vitin e fundit. Për arsye të një konkursi që zhvillohet nga Fakulteti, kam nevojë të marr informacion në lidhje me lejet mjedisore, konkretisht sipas ligjit shqiptar, A duhen | 13.05.2024 | Referuar kërkesës së tuaj me lëndë "Kërkesë informacioni në lidhje me lejet mjedisore", ju bëjmë me dije se:<br><br>Të gjithë aktivitetet të cilat ushtrojnë veprimtari të cilat përfshihen në shtojcën 1 të Ligjit Nr. 52/2020 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 10 448, datë 14.7.2011, "Për Lejet e Mjedisit", të ndryshuar i nënshtrohen procedurës së pajisjes me ljeje mjedisore. | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | hotelet të pajisen me leje mjedisore? | | | | |
| 12. | 14.05.2024 | Kompania V*** ka fituar ankandin e shpalluar nga Ministria e Infrastruktu-rës dhe Energjisë për instalimin e Parkut Eolik Kryevidh ku do të instalohen 12 aerogjenerat-orëve të prodhimit të energjisë elektrike nga fuqia e erës me një kapacitet total të | 14.05.2024 | Veprimtaritë që janë objekt i ligjit Nr.10448 datë 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit" i ndryshuar janë të klasifikuara në shtojcën 1 e këtij ligji. Dokumentacioni për veprimtaritë është i përcaktuar në Kreu II dhe III të VKM Nr.419 datë 25.06.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A dhe B për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja"<br><br>Kërkuesi që aplikon pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) për pajisjen me leje mjedisi të tipit A, duhet të dorëzojë këto dokumente:<br>a) Formularin informues për pajisje me leje mjedisi të tipit A, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi;<br>b) Mandatpagesën për tarifën përkatëse për lejen e mjedisit të tipit A, sipas nenit 25 të ligjit nr.10448, datë 14.7. 2011, “Për lejet e mjedisit”;<br>c) Çdo informacion tjetër që kërkuesi i lejes kërkon të merret parasysh gjatë shqyrtimit të aplikimit;<br>ç)Raportin mbi sigurinë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e rreziqeve nga aksidentet madhore, kur kërkohet;<br>d) Relacion rreth dëgjesës me publikun, sipas përcaktimit në pikën 13 të kreut V të këtij vendimi<br><br>Kërkuesi që aplikon pranë QKB -së për pajisjen me leje mjedisi të tipit B duhet të dorëzojë këto dokumente:<br>a) Formularin informues për pajisje me leje mjedisi të tipit B, sipas shtojcës 2, bashkëlidhur këtij vendimi;<br>b) Mandatpagesën për tarifën përkatëse për lejen e mjedisit të tipit B, sipas nenit 25 të ligjit nr.10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”; | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | instalimit prej 72.6 MW në 25 Korrik të 2023. Në këtë kontekst kompania do ti nënshtrohet proçesit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM), ndaj do tju luteshim për një sqarim më të plotë në lidhje me hapat dhe Proçesin e VNM deri ne pajisjen me Leje Mjedisi. | | c) Çdo informacion tjetër që kërkuesi i lejes kërkon të merret parasysh gjatë shqyrtimit të aplikimit;<br>ç) Raportin mbi sigurinë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e rreziqeve nga aksidentet madhore, kur kërkohet.<br>d) Relacionin rreth dëgjesës me publikun, sipas përcaktimit në pikën 13 të kreut V të këtij vendimi.<br><br>Operatori i dërgon Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, kërkesën, nëpërmjet QKB-së, referuar Ligjit Nr.10081, datë 23.2.2009 "Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.<br><br>Bazuar në ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" i ndryshuar, aplikimi kryhet në platformën qeveritare "E-albania", në zbatim të:<br><br>• VKM 828, datë: 28.12.2023, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 686, datë: 29.07.2015, "Për miratimin e rregullave, përgjegjesive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore", të ndryshuar, si dhe Urdhërit të Kryeministrit Nr. 153 Prot, datë: 25.11.2019 "Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm on-line nga data: 01.01.2020", | | |
| 13 | 17.05.2024 | Jam një banor në | 24.05.2024 | Në vijim të e-mail tuaj, referuar ankimit mbi ndotjen e ajrit, nga aktiviteti i subjektit "Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | zonën e Krrabës të rrethit të Tiranës, këtu ka disa vite që është vendosur një fabrikë bitumi (asfalti) edhe prej shume kohësh ka super ndotje të ajrit, nuk mbushemi me ajër kemi dhe prindërit që janë moshë të madhe edhe jetojnë në këtë zonë për ajër të pastër nga kjo fabrikë bitumi që është një katastrofë për ndotjen e ajrit. Ju lutemi të merni masa për këtë shqetësim! Jam në pritje të një | | Ndriçimit Ent Publik ”, me adresë Njësia Administrative Krrabë, pranë tunelit, ju bejmë me dijeni sa vijon:<br><br>Në datë 22.05.2024 grupi inspektorëve pranë Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër kreu një kontroll/verifikim në subjektin “Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Ent Publik”, nga ku rezultoi se:<br><br>Shoqëria " Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Ent Publik " e ushtron aktivitetin i pajisur me leje mjedisore tipi B, duke respektuar kushtet e lejes mjedisore dhe kërkesat ligiore, ku lidhur me shkarkimet në ajër ka dorëzuar në AKM me nr.prot. 112, datë 08.01.2024, dokumentacionin tekniko ligjor dhe raportin 6 mujor të vetmonitorimit, si dhe referuar raportit analitik të analizave të kryera nga laborator i licensuar dhe akredituar, shkarkimet në ajër rezultojnë brenda normave të lejuara.<br><br>Lidhur me përputhshmërinë e aktivitetit me kushtet e lejes mjedisore dhe kërkesat ligiore, në zbatim të legjislacionit mjedisor dhe vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 568, datë 17.07.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit" të ndryshuar, nga ana e Agiencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durës, Dibër, aktiviteti do të monitorohet dhe inspektohet në vijim dhe në rast të kostatimit të shkleljeve do të merren masa konform legjislacionit në fuqi. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | përgjigje nga ju! | | | | |
| 14 | 17.05.2024 | Në lidhje me aplikimin e subjektit “Koorporata Elektro-energjetike Shqiptare” sh.a, në lidhje me procedurën për njoftim të procedurës së thelluar të VNM-së për projektin “Hidroce-ntrali i Skavicës”, me vendodhje në luginën e Drinit të Zi. Subjektit e cila është refuzuar automatic-isht nga sistemi i e_lejeve, pas tejkalimit të afatit ligjor,desha të di nëse: | 28.05.2024 | Agjencia Kombëtare e Mjedisit morri në shqyrtim aplikimin e subjektit “Koorporata Elektroenergjetike Shqiptare” sh.a, në lidhje me procedurën për njoftim të procedurës së thelluar të VNM-së për projektin “Hidrocentrali i Skavicës”, me vendodhje në luginën e Drinit të Zi. Subjektit është refuzuar automatikisht nga sistemi i *e_lejeve*, pas tejkalimit të afatit ligjor.<br><br>Subjekti Koorporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a nuk ka riaplikuar për kryerjen e procedurës së VNM-së së Thelluar. | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 1. Nëse subjekti Koorporata Elektro-energjetike Shqiptare sh.a ka riaplikuar për kryerjen e procedurës së VNM-së së Thelluar.<br><br>2. Nëse po, mund të më nisni dokumentat përkatëse të aplikimit | | | | |
| 15. | 27.05.2024 | 1. Sa llogaritet niveli i ndotjes akustike (ditën dhe naten) në Bashkinë e Tiranës për tre vitet e fundit 2023 – 2022 – 2021 ?<br><br>2. Në rast të mungesës së informacion it të | 29.05.2024 | 1-Të dhënat e monitorimit i gjeni në faqen zyrtare të AKM https://akm.gov.al/raporte-dhe-publikime/<br><br>2-Matjet e fundit nuk janë publikuar ende në faqen zyrtare, sapo raporti të jetë gati do mund të aksesoni të dhënat www.akm.gov.al<br><br>3-Agjencia Kombëtare e Mjedisit bazuar në Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit realizon monitorimin e zhurmave urbane.<br>Ndikimi kryesor në rritjen e nivelit të zhurmave në qytetet e monitoruara është vlerësuar fluksi i madh i automjeteve, gjendja motorike e tyre në qarkullim dhe mosha e vjetër e automjetit, të cilat sjellin uljen e parametrave optimale të çertifikatës teknike të automjetit, lidhur me emetimin e zhurmës, boritë e automjeteve ku drejtuesit e të cilëve u bien pa kriter. | Përfunduar | Nuk ka |

<table>
<tr>
<td></td>
<td></td>
<td>mësipërm lutemi të na informoni për matjet e fundit të AKM mbi ndotjen akustike në Bashkinë Tirane?<br><br>3. Cilat janë burimet kryesore të ndotjes akustike në kryeqytet?<br><br>4. Cilat zona në kryeqytet janë më të ndikuara nga ndotja akustike?<br><br>Do ju lutesha të më referoni një raport specifik i cili përmban të dhënat e fundit të matjes së ndotjes akustike në kryeqytet,</td>
<td></td>
<td>4-Pikat e monitorimit në Tiranë paraqiten në tabelën si vijon.
<table>
<tr><th>Nr.</th><th>Stacioni monitorimit</th><th>Qyteti</th><th>Gjatësia</th><th>Gjerësia</th></tr>
<tr><td>1</td><td>Shkolla e Bashkuar</td><td>Tiranë</td><td>41°20'42.41"N</td><td>19°50'16.00"E</td></tr>
<tr><td>2</td><td>Farmacia 10</td><td>Tiranë</td><td>41°20'23.60"N</td><td>19°49'44.65"E</td></tr>
<tr><td>3</td><td>Stacioni i trenit</td><td>Tiranë</td><td>41°20'9.80"N</td><td>19°48'57.16"E</td></tr>
<tr><td>4</td><td>Kryqëzimi “21 Dhjetori”</td><td>Tiranë</td><td>41°19'32.87"N</td><td>19°48'14.19"E</td></tr>
<tr><td>5</td><td>Pallati i Kongreseve</td><td>Tiranë</td><td>41°19'14.61"N</td><td>19°49'15.47"E</td></tr>
<tr><td>6</td><td>Ish Banka Amerikane (Blloku)</td><td>Tiranë</td><td>41°19'8.20"N</td><td>19°49'1.95"E</td></tr>
<tr><td>7</td><td>Kryqëzimi “Vasil Shanto”</td><td>Tiranë</td><td>41°19'16.51"N</td><td>19°48'21.08"E</td></tr>
</table></td>
<td></td>
<td></td>
</tr>
</table>

<table>
<tr>
<td></td>
<td></td>
<td>sipas pyetjes 1 dhe 2 të kërkesës për informacion , pasi në linkun e publikimeve për shkak të numrit të shumtë të raporteve nuk di të orientohem.</td>
<td></td>
<td>
<table>
<tr><td>8</td><td>Rruga e Elbasanit</td><td>Tiranë</td><td>41°19'30.04"N</td><td>19°49'32.07"E</td></tr>
<tr><td>9</td><td>Partizani i panjohur</td><td>Tiranë</td><td>41°19'41.79"N</td><td>19°49'20.33"E</td></tr>
<tr><td>10</td><td>Skënderbeu</td><td>Tiranë</td><td>41°19'40.28"N</td><td>19°49'8.92"E</td></tr>
<tr><td>11</td><td>Selvia</td><td>Tiranë</td><td>41°19'58.26"N</td><td>19°49'21.31"E</td></tr>
<tr><td>12</td><td>Laprakë<br><br>(Kryqëzimi i Spitalit)</td><td>Tiranë</td><td>41°20'19.05"N</td><td>19°47'19.33"E</td></tr>
<tr><td>13</td><td>Drejtoria e Policisë</td><td>Tiranë</td><td>41°19'30.27"N</td><td>19°48'47.04"E</td></tr>
<tr><td>14</td><td>Shkolla Edit Durham</td><td>Tiranë</td><td>41°19'16.27"N</td><td>19°48'50.26"E</td></tr>
<tr><td>15</td><td>Stadiumi Dinamo</td><td>Tiranë</td><td>41°19'4.01"N</td><td>19°48'41.70"E</td></tr>
</table>
</td>
<td></td>
<td></td>
</tr>
</table>

Referuar të dhënave të monitoruara në stacionet e Tiranës kemi tejkalim të normës ditën dhe të normës natën në të gjitha stacionet e monitoruara.
Nivelet më të larta ditën janë monitoruar në stacionin "Partizani i Panjohur" dhe më e ulëta në stacionin "Shkolla e Bashkuar".
Nivelet më të larta natën janë monitoruar në stacionin "Kryqëzimi Vasil Shanto" dhe më e ulëta në stacionin "Stadiumi Dinamo".

Po ju nisim measateret vjetore të monitorimit të zhurmave urbane si më poshtë:

| LAeq/Ditën dB(A) | Viti 2021 | Viti 2022 | Viti 2023 | Norma e OBSH |
|---|---|---|---|---|
| Tiranë | 63.36 | 62.91 | | 55 |

| LAeq/Natën dB(A) | Viti 2021 | Viti 2022 | Viti 2023 | Norma e OBSH |
|---|---|---|---|---|
| Tiranë | 53.05 | 50.8 | | 45 |

Të dhënat e monitorimit për 2023 ende nuk janë të publikuara në faqen zyrtare.

Gjithashtu, në faqen e AKM www.akm.gov.al në Raportin e Gjendjes në Mjedis për 2022 në faqen 53 është raporti i monitorimit të zhurmave
Në Raportin e Gjendjes në Mjedis 2021 në faqen 162.